

V E N D I M
Nr.308, datë 1.7.1999

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR PUBLIKIMIN E SHPALLJES SË SHPRONËSIMIT
PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA
NDËRTIMI I ZGJERIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR "KTHESA E KAMZËS - ZOGU I ZI"**

Në mbështetje të nenit 100 dhe të nenit 117 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.7848, datë 25.7.1994 "Për shpronësimin për interes dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme", me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për publikimin e shpalljes së shpronësimit për interes publik të pasurive të paluajtshme, 17 891.5 m² truall, 1 301 m² objekte ndërtimi, që preken nga ndërtimi i zgjerimit të segmentit rrugor "Kthesa e Kamzës - Zogu i Zi".

2. Listat emërore të pronarëve të këtyre pasurive të paluajtshme, që do të shpronësohen, së bashku me sipërfaqe përkatëse të shpronësimit, i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Rrethit të Tiranës, Bashkia e Tiranës dhe Komuna e Kasharit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko